

Mësoje tekstin e këngës dhe këndoje atë.

Në pranverë

Teksti dhe muzika: Desara Beqari Gjonej

Kur vjen pranvera
gëzohen të mëdhenj dhe fëmijë.
Nganjëherë ndriçon dielli,
nganjëherë bie shi.



Shiu pik-pik-pok,
pikon në tokë.
Shiu pik-pik-pok
pikon në tokë.




Hidhem nëpër ujë.
Gropa të vogla, të mëdha!
Hidhem nëpër ujë, çup-çup-ça!

Shih, ylberi ngjyra-ngjyra!
Seç na qesh fytyra!
Shih, ylberi ngjyra-ngjyra!
Seç na qesh fytyra!


Çfarë surprize, hej, hej!
Diell, shi, ylber!
Çfarë surprize, hej!
Diell, shi, ylber!

Qielli i kaltër, qielli gri,
herë me diell, herë me shi.
Luledele gjithandej,
tulipanë të kuq, të verdhë.



Qielli i kaltër, qielli gri,
herë me diell, herë me shi.
Luledele gjithandej,
tulipanë të kuq, të verdhë.

Mami, pantallonat e shkurtra ku janë?
Babi, po syzet e diellit, ku janë?



Çadrën sot lë në shtëpi,
që të lagem nëpër shi.
Çadrën sot lë në shtëpi,
që të lagem nëpër shi.

Çfarë surprize, hej, hej!
Diell, shi, ylber!
Çfarë surprize, hej!
Diell, shi, ylber!

